

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale gjyqtarit Adem Shabani, me asistentin Muedin Rexhepi, në çështjen penale kundër të akuzuarve B.B., nga Gjilani rr.”..... II”nr....., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par 1 të të KPK-së, dhe S.S. nga fshati, Komuna Viti, për shkak të vepres penale pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par 1 të KPK-së të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike Komunale në Ferizaj PP.nr.921/2017 e dt.18.07.2007, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt.26.08.2016, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarëve:

1.I akuzuari B.B., nga Gjilani rr.”..... II ” nr..., data e lindjes..... nga i ati K. dhe e ëma R. e gjinis E., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, babë i dy fëmijëve i gjendjes së mesme ekonomike, posedon letërnjoftimin me nr....., mbrohet në liri.

2.I akuzuari S.S., nga fshatië, Komuna Viti, data e lindjes.....nga i ati A. dhe e ëma R. e gjinis A., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion tregtar, mbrohet në liri.

JANË FAJTORË

I akuzuari B.B.

Sepse me dt. 17.05.2007, rreth ores 19:30, në Ferizaj në rr”Rexhep Bislimi” në NTP “.....” pron e të dëmtuarit A.S. në bashkëkryerje edhe me dy persona tjerë tani për tani të panjohur, me qëllim që me përvetsimin e kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, me mjet të përshtatshëm ka zgjidhur telin që ka shërbyer si rrethojë e depos jan future brenda në depo dhe nga aty kanë marrë 15 tuba llamperi alumini vlerë prej 1500€, të cilat ja shet të pandehurit të dytë.

me të cilën kryen në bashkëkryerje vepër penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 nënpar 1 lidhur me nenin 23 të KPPK-së.

I akuzuari S.S.

Kah fundi i muajit maj 2007 gjatë orëve të paraditës, në fshatinë në depon e tij për grumbullimin e materialit-hekurishte, ka pranuar dhe blerë 15 tuba të aluminit nga i pandehuri B.B. edhe pse e ka ditur se i njejt material është vënë në dorë me anë të vjedhjes.

me të cilën kreu veprën penale pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.1 të KPPK-së

Gjykata në bazë të nen. 3,34, 36, 38, 64 dhe 66 të KPK-së dhe neneve 361 dhe 365 të KPPK-së e

G J Y K O N

I. Të akuzuarin **B.B.** me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3/tre/ muajve.

Pas shpalljes së aktgjykimiti dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3/tre/ muajve konform nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit i zëvendësohet me dënim me gjob në shum prej 500 / pesëqindë / Euro.

Dënimin e shqiptuar me gjobë do ta paguaj pasi aktgjykimi të merr formen e prerë nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

Në rast se dënimi i zëvendësuar me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në mënyra tjera të parapara në nenin 46 të KPRK-së, dënimi do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 Euro do të vuaj një ditë burgimi.

I dëmtuari, A.S., nga fshati, Komuna Lypjan, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj në shumën prej 30 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në bazë të nenit 363 paragrafi 1 nënpar 1.3, të KPPK-së

REFUZOHET AKUZA

II. Kundër të akuzarit **S.S.** nga fshatië, Komuna Viti

Sepse kah fundi i muajit maj 2007 gjatë orëve të paraditës, në fshatinë në depon e tij për grumbullimin e materialit-hekurishte, ka pranuar dhe blerë 15 tuba të aluminit nga i pandehuri B.B. edhe pse e ka ditur se i njejt material është vënë në dorë me anë të vjedhjes.

Meqë ka kaluar afati i parashkrimit absolute të ndekjes penale për veprën penale pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.1 të KPPK-së.

Konform nenit 91 par.1 pika 6 e KPK-së për veprën penale nuk mundë të ndërrmerren veprime për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Publike Komunale në Ferizaj me aktakuzën PP.nr.921/2017 e dt.18.07.2007 ka ngarkuar të akuzuarit: B.B., nga Gjilani rr.”..... II”,nr....., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par 1 të të KPK-së, dhe S.S. nga fshati, Komuna Viti, për shka të vepres penale pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par 1 të KPK-së.

Gjyakta në këtë çështje penale ka ndërrmar disa herë veprime procedurale por nuk ka mundur që të sigurohen të akuzuarit ku nga fletëkthesat është thekësuar se i akuzuar B.B. nuk gjindet në shtëpi, gjindet jashtë shtetit në shtetin e Francës.

Gjykata bazuar në fletëdorzimet i ka lëshuar Urdhëresë Policisë-Stacionit Policor në Gjilan që të akuzuarin B.B. pas lëshimit të urdhëresës për lëshimin e letërreshtimit qendror i akuzuar B.B. të sjellet me detyrim mirëpo nga policia gjykata ka pranuar njoftimin-Memorandumin zyrtar me dt.24.11.2014 se i akuzuari gjindet në shtetin e Francë, ku gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 535 të KPPK-së kishte lëshuar me dt.22.12.2015 Urdhëresë për Lëshimin e Letërreshtimit Qendror dhe me të kthyer i akuzuari në Kosovë menjëher nga ana e plocicis është sjellur në gjykat dhe gjykata ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPRK-së me dt.26.08.2016, ka mbajtur shqyrktimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Ismet Rrahmani dhe i akuzuari.

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari i dorzon aktakuzen të akuzuarit dhe i jep kohë për lexim i cili pajtohet që të mbahet seanca gjyqësore.

Në fillim të shqyrtimit fillestar i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPRK-së, pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drerjtat e të akuzuarit janë rerspektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën ndaj të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari B.B., ka theksuar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet por në kohen kur e ka kryer këtë vepër penale ka

qenë i moshës së re nuk ka menduar për pasojat, pendohet për veprën e kryer i kërkon falje të dëmtuarit, tani është i martuar babë i dy fëmijëve punon jashtë shtetit të Kosovës në shtetin e Francës i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të sanksionit penal të marrë për bazë pranimin e fajsisë.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPRK-së, është i bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimit të fajsisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPRK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajsisë, mbrojtësit dhe të dëmtuarit

Prokurori i shtetit Ismet Rrahmanii ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit pasi pranimi i fajsisë është bërë konform ligjit dhe të gjitha provave që gjinden në shkresat e kësaj lënde penale.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit B.B. manifestohen të gjitha elementet në bashkëkryerje veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 nënpar 1 lidhur me nenin 23 të KPPK-së.

Gjykata duke u mbështetur në nenin 253 par.1 nënpar.1.3 të KPPK-së kundër të akuzuarit S.S. e hudhi aktakuzën për veprën penale pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.1 të KPPK-së dhe pushoi procedurën penale nga që: “Ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit” (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale), konfomsë nenit 91 par.1 pika 6 e KPPK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit kundër të akuzuarit B.B. gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPPK-së të cilat ndikojnë në llojinë dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori pranimin e fajsisë nga ana e të njëjtit, me qka ka treguar sinqeritet në procedurën penale, është penduar për veprën e kryer, i kërkon falje të dëmtuarit, veprën penale kur e ka kryer ka qenë i moshës së re, tani është martuar babë i dy fëmijëve ka emigruar në shtetin e Francës ku atje edhe punon, mbajtës i familjes, mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe rrezikshmerinë konkrete të kësaj vepre penale, dhe në kuptim të të gjitha këtyre, i shqiptoi të akuzuarin B.B. me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3/tre/ muajve dhe pas shpalljes së aktgjykimiti dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3/tre/ muajve konform nenit 47 të KPPK-së, me pëlqimin e të akuzuarit i zëvendësohet me dënim me gjob në shum prej 500 / pesëqindë / Euro, e në rast se dënimi i zëvendësuar me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në mënyra tjera të parapara në nenin 46 të KPPK-së, dënimi do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari prë çdo 20 Euro do të vuaj një ditë burgimi, duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me te arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të

preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Konformë nenit 463 par.1 lidhur me par.3 të KPPRK-së gjykata të dëmtuarin A.S., nga fshati, Komuna Lypjan, për realizimin e kërkeses pasuroro-juridike e ka udhëzuar në kontest civil.

Konformë nenit 450 par.2.6 të KPPRK-së është obliguar i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
P nr.55/2013 me datë 26.08.2016

Asistenti
Muedin Rexhepi

Gjyqtari
Adem Shabani